



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:242949  
Datë: 19.07.2024  
Numri i dokumentit: 05959472

**C-IV.-14-3239**

*Ankuesi:*

M R nga fsh. B- D  
, K Ferizaj

*Kundër*

*E paditura:*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit AKP-së-Zyra Rajonale në Gjilan, Rr. “Dritan Hoxha”,  
Nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Dr.sc. Murat Hulaj, me datë 19 korrik 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET**, ankesa e ankuesit M R, nga fsh. Bajnic,Doganaj, Komuna e Ferizajt si e pabazuar dhe **VËRTETOHEN**, vendimet e Autoritetit të Likuidimit nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0259 i datës 19 mars 2014, me të cilin ju ka refuzuar kërkesa për kompensimin e 3 (tri) pagave të pa paguara si ishë punëtor **NTSH. ”Tregtia ”, në Ferizaj**, për muajt –Mars, Prill dhe Majë pa specifikim periudhe viti në shumën kërkuar prej 450.00 euro, si dhe vendimi me nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0260, i datës 19 mars 2014, më të cilin kërkuar/tani ankusi kishte kërkuar dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës-kontratës në shumë prej 4,950.00 euro, si vendime të drejta dhe të bazuar në ligjë nga AL të AKP-së.
- II. Ankusi Lirohet nga shpenzimet e taksave gjyqësor si përfitues i ndihmes sociale.

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 28 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0259 i datës 19 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ju ka refuzua kërkesa për kompensimin e 3 (tri) pagave të pa paguara për muajt –Mars, Prill dhe Majë te vitit 2008 në shumë prej 450.00 euro si dhe vendimi me nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0260, i datës 19 mars 2014, më të cilin kërkusit/tani ankusi kishte kërkuar dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të mardhenjës së punës-kontratës në shumë prej 4,950.00 euro, si ishë punëtor i **NTSH. "Tregtia", në Ferizaj**. Përmes ankesës ka potencuar se vendimi i AL-ës, është sjellë me: Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe me aplikim të gabuar të së drejtës materiale duke i Propozuar Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë ankesën ton ta aprovoj si të bazuar në ligj, ndërsa vendimin e atakuar nr. **GJI097-0259 i datës 19 mars 2014**, ti anuloj si të pa bazuar në ligj dhe ta detyroj kundër propozuesin (AKP-në) që propozuesit tija kompensoj të ardhurat personale të pa paguar për 3 muaj në shumë prej 450.00 euro dhe dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të mardhenjës së punës-kontratës në shumë prej 4,950.00 euro. Ankuesi/paditësi me teje arsyeshmërin e ankesës e lidhë duke sqaruar se ka qenë në mardhenjë pune të rregullt të **N.T.SH.** „TREGTIA„ në Ferizaj ku ka realizuar të ardhura personale me të cilat i ka mbajtur veten dhe familjen e tij. Sipas dispozitave të nenit 131 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar citojmë se punëtorët sipas bazës së punës në ndërmarrjen shoqërore i garantohet e drejta në të ardhura personale në lartësinë e cila e siguron Sigurimin material social të punëtorit dhe familjes së tij. Kjo e drejtë ju ka pranuar punëtorit edhe me ligjin mbi marrëdhënien e punës të Kosovës në ish Jugosllavi. Gjithashtu sipas dispozitave të nenit 224 të LMPB, si dhe ligjit mbi marrëdhënien e punës para luftës në Kosovë (Ligji mbi marrëdhënien e Punës .GZ e KSAK. NR 24/84) punëtorit ju ka garantuar e drejta Kushtetuese dhe ligjore në të ardhura personale dhe duke u nisur nga gjendje faktike dispozitave të ligjit mbi punën e bashkuar dhe ligjit mbi marrëdhënien e punës, këto të drejta me vendimin e atakuar që e ka nxjerr AKP-ja – zyra rajonale e Gjilanit me nr. dhe dt.tw (cekur më lartë, punëtorit ju ka shkel e drejta themelore për jetës, c drejta nga marrëdhënia e punës për mos pagimin tri pagave për muajin Mars, Prill, Maj të vitit 2008, si dhe ndërprerja e punës sipas kontratës.

Gjendja e përshkruar më lartë dhe refuzimin e kërkesës së punëtorit që e ka nxjerrë kunderpropozuesi për refuzimin e pagesës së tri pagave është e pabazuar në asnjë ligj apo dispozitë ligjore.

Gjithashtu duke u mbështetur në dispozitat e nenit 231 të ligjit mbi punën e bashkuar, punëtorit i takon e drejta në kompensimin e të ardhurave personale për punën e kryer në ndërmarrjen gjegegjëse pasi që nga dokumentacioni që gjendet te kundërpropozimi zyra Rajonale në Gjilan mund të vërtetohet se punëtorët në fjalë nuk ju kanë paguar për tre muaj të ardhurat personale për muajt Mars, Prill, Maj 2008, atëherë edhe kur bordi i AKM-së ka vërtetuar shitjen e plotfuqishme të ndërmarrjes në fjalë dhe se nga informata që cekem më lartë për pagat që ju janë mbetur pa paguar do të shqyrtohen sipas procedurës të likuidimit të ndërmarrjes ashtu që nga kjo informat punëtori nuk e ka humbur të drejtën e ushtrimit të kërkesës dhe afatit për pagesën e të ardhurave personale dhe dëmshpërblimin nga largimin nga puna.

Ashtu që i propozoj Gjykatës në fjalë që të kërkon nga kundërpopuzuesi zyra regjionale në Gjilan i tërë dokumentacioni i ndërmarrjes ku do të vërtetohet se propozuesit nuk u janë paguar të ardhurat personale për tre muajt e fundit para shitjes së ndërmarrjes dhe të detyrohet kundërpopuzuesi-AKP-ja që paditësit të ja kompensoj pagat e papaguar. Kundërpopuzuesi duke vendosur për kërkesën e punëtorit në fjalë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe kështu ka ardhur deri te vërtetimit të gabuar i të drejtës materiale. Pretendimeve ankimore të përshkuara si me lartë ankuesi/ paditësi ja ka bashkangjitur provat vijuese:

- **Vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. GJI097-0259 i datës 19 mars 2014 Informata e dt. 27 maj 2008 të dorëzuar punëtorëve të N.T.SH.,TREGTIA,, Ferizaj.**

Me datë 03 prill 2024, e paditura AKP-ja parashtroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht me rastin e marrjes së vendimeve nr. GJI097-0259 dhe GJI097-0260 të datës 19 marsë 2014 duke refuzu si plotësisht të pavlefshme kërkesat e tij, të parën për 3(tri) pagat e papaguar në shumë prej 450.00 euro për periudhën kohore mars, prill dhe maj 2008 dhe kërkesën e dytë më të cilën kishte kërkuar nga AL i AKP-së, dëmshprblimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës si ishë punëtor i N.T.SH.,TREGTIA,, Ferizaj për shumën e kërkuar prej 4,950.00 euro.

Me teje në përgjigje të mbrojtjes Autoriteti i Likuidimit pranë AKP-së, si administrus i N.Sh.TREGTIA,,(në Likuidim) potencon se 2(dy) Vendimet e AL janë të bazuar bazuar në faktet dhe bazat ligjore vijuse:

Sipas Nenit 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit parashikon:

Se elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligi për refuzimin e një kërkesë apo Interesi të pretenduar të kapitalit apo pronsisë: ... "kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme "

Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar ne Gazeten Zyrtare Nr. 53 te vitit 1976), i aplikueshem sipas nenit 1, të Rregullores se UNMIK-ut 1999/24, parashikon qe "pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo seciles kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedhë nga marëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet"

Parashtruesi e ka parashtruar Ankesen më dt. 28.04.2014 kundër Vendimeve duke pretenduar: Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

### **Argumentet e Palës Kundërshtare**

Pala Kundërshtare i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Ne paragrafet në vijim, Pala Kundërshtare do të paraqese arsyet pse Ankesa është e papranueshme si dhe e pabazuar.

### **Ankesa e Parashtruesit është e papranueshme**

Pala Kundërshtare konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure Blyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e Vendimit të

Autoritetit të Likuidimit. Në këtë kontekst, 74.2 Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DhPGIS, kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi nuk ka treguar se cill nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e Vendimit, dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DhPGIS, kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vetë Parashtruesit, Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për ta shfuqizuar Vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086, ankesa në fjalë është e pabazuar.

### **Pretendimet e Parashtruesit janë të parashkruara për Vendimin GJI097-0259.**

Parashtruesi e ka paraqitur kërkesën në zbatim të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën dhe e vlerëson si të pavlefshme. Neni 36.2 i Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034, për AKP-në parashikon: "...elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësive: .. kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme".

Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshem sipas nenit 1, të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që "pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo seciles kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedhë nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet"

Në bazë të dispozitave të mësipërme, për të ndërprerë parashkrimin kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë, apo në ndonjë autoritet kompetent brenda tri viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit.

Pra tre vite nga koha kur parashtruesi nuk ka përfituar nga ndermarrja të ardhurat personale të pretenduara, në rastin në fjalë tre vite nga korrik 2008.

Nuk ka asnjë provë përpara këtij Autoriteti të Likuidimit që parashtruesi ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë Gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tri vjeçare si më sipër. Prandaj, ky Autoritet i Likuidimit refuzon këtë kërkesë si të pavlefshme.

### **Pretendimet e Parashtruesit janë të parashkruara për Vendimin GJI097-0260 dt.19.03.2024**

Parashtruesi e ka paraqitur kërkesën në zbatim të nenit 40.1.6.2 i shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, parashikon që parashtruesve u takon e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakoheshme të kontratës së punës nëse "janë pushuar nga puna si rrjedhojë apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP sipas nenit "6.1 apo 6.2". Privatëzimi është një veprim i paraparë në përputhje me nenin 6.2.1 të Ligjit të AKP-së.

Për sa me sipër, ky Autoritet i Likuidimit e refuzon kërkesen për demshperblim për nderprerje të parakoheshme të kontrates së punës së pavlefshme.

Si përfundim nga arsyerat e sipërcekura pala Kundërshtare, kërkon nga gjykata të:  
Refuzojë Ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe të Vërtetoj Vendimin e Autoritetit Autoritetit të Likuidimit në pajtim me Nenin 74.4 të Ligjit Nr. 06/L-086.  
Së bashku me përgjigje në mbrojtje ka bashkangjitur si prova : Dy Vendimet e autoritetit të Likuidimit sipas numrave të kërkesave GJI097-259 dhe GJI097-260 të datës 19.03.2014 dhe Emrimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me teje ne mbrojtje (AKP) si palë Kundërshtare konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Në këtë kontekst, 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DhPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e Vendimit, dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DhPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vetë Parashtruesit, Vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar Vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të Nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086, Ankesa në fjalë është e pa bazuar dhe se ***Prendimet e Parashtruesit janë të pavlefshme.***

Neni 36.2.2 Shtojces se Ligjit për AKP-ne, parashikon elementet në vijim që përbejnë të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kerkese apo interesi të pretenduar të pronësisë... dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar, i paraqitur nga pretenduesi apo bartësi i interesit te pretenduar, mbetet jo i plote edhe pas kërkesës nga kreditor pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese”.

Bazuar në dispozitat e mësipërme, kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër Kompetent brenda tre vjetëve, nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Prandaj, ky Autoritet i Likuidimit vendosi që të refuzojë këtë kërkesë si të pavlefshme. Prandaj, Autoritet i Likuidimit arriti ne përfundim se kërkesa është e pavlefshme. dhe si përfundim ne saje të cekurave më lartë Gjykatës i propozon qe të: Refuzojë Ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar; dhe Vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit në pajtim me Nenin 74. 4, të Ligjit Nr. 06/L-086.

Me qëllim të sqarimit dhe pretendimeve ankimuse të ankusit të paraqitura kundër dy Vendimeve të AL-së adresuar përmes ankeses së pranuar me dt. 28 prillë 2014 në DHPGJS-së e në pamjaftushmeri provash të dorëzuara me ankesë/padi në DHPGJS, ndër veprimet tjera sipas detyres zyrtare gjykata me datë 29.04.2024 ankusit I është lëshuar URDHËR për plotësimi qe ti sjellë provat vijuse:

- Librezen e punës,
- Njoftimin për ndërprerjen e mardhënjes se punës në emrin tuaj,
- Listen e pagave më të cilat dëshmohet se I njëjti ka pranuar paga nga N.SH si dhe provat tjera më të cilat do ti mbështet pretendimet ankimore, mirëpo përkunër pranimit te urdhërit të dorëzuar me fletëkthes në mënzrë të rregullt I njëjti nuk ka sjellur provat e kërkuara nga gjykata.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesat ndaj vendimeve të AL-të AKP-së, me numra nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0259 dhe me nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0260, të sjellur me datë 19 mars 2014, refuzohen si te pabazuara.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086, të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3, të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Kërkesa e ankuesit ka të bëjë me njohjen e te drejtës ne pagesat se te ardhurave personale te perealizuara për 3 (tri) pagave të pa paguara për muajt –Mars, Prill dhe Majë te vitit 2008 në lartësi prej 450.00 euro si dhe dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës në lartësi prej 4,950.00 euro, duke i propozuar gjykatës qe tia aprovoj ankesen, ndërsa vendimet e atakuara me nr. 11746/14 dhe 11747/17 te dt. 20.03.2014 ti anuloj si të pabazuara në ligjë dhe ta detzroj kundërpropozusin (AKP-në) qe propozusit tja kompenzoj të ardhurat personale të pa paguar prej 3(tre) muajve dhe dëmshpërblimin për ndërprerjen e mardhënjes se –kontratës në shumat e kërkuara si në ankesë (450,00 +4,950.00) euro.

Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.1 e po të njëjtit nen, parasheh pagesën e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto.

Gjykata gjen se kërkesa është e pabazuar për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në neni 40, paragrafi 1.6.1 i referohet vetëm prioritetit të tri (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar.

E paditura në dy vendimet e saja **me saktësishtë në referim te Vendimit** nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0259 i datës 19 mars 2014 **dhe vendimit** nr. 11746/14 përkatësisht GJI097-0260, i datës 19 mars 2014, me të cilët ka refuzuar kërkesën e ankuesit në pjesën arsyetuese kur i është referuara nenit 40.1.6.1 të shtojcës së ligjit të AKP-së nuk ka mohuar se punonjësve u takojnë tre pagat e fundit sipas prioriteteve të cilëve mund ti kenë mbetur të papaguara nga NSH, por ka arsyetuar se “*kërkesa për paga të papaguara duhet të mbështetet në prova që vërtetojnë një detyrim të tillë të ndërmarrjes*”, gjë që ankuesi nuk e ka bërë. Gjykata vëren se ankuesja kërkesën për kompensimin e pagave për të ardhurat personale të porealizuara nga 3 (tri) pagave të pa paguara për muajt –Mars, Prill dhe Majë te vitit 2008(tani viti i precizuar vetem në ankesë) në lartësi prej 450.00 euro si dhe dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës në lartësi prej 4,950.00 euro, €, nuk e ka mbështetur me asnjë provë para AL prandaj vendimet e AL konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Ankuesi edhe me ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se si ishë punëtor i **N.T.SH.,,TREGTIA,, Ferizaj** ,kjo e fundit i ka mbetur borxh pagat e kërkuara. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, nuk është dëshmi me të cilat dëshmohet se N.Sh. i ka mbetur borxh ankuesit.

Ankuesi edhe pas dorëzimit të mbrojtjes së AKP-së, përgjigjes se dhënë në raport me mbrojtjen e të paditurës dhe urdhrin të gjykatës të dt. 29 prillë 2024, ka dështuar që të dorëzoj prova me të cilat do të dëshmohej se NSH i ka mbetur borxh paga e pretenduara, andaj Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij, në kompensim për paga të pa paguara, dhe për kompesimin e kërkuar në emër të dëmshpërblimit të kërkuar për ndërprerjen e parakohshme të kontrates së punës si ishë punëtor i N.SH nuk ka arritur që ti mbështet me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla ankesat ndaj tij të parashtruara ndaj 2(dy) vendimeve të AL-së janë refuzuar si të pabazuara, perderisa vendimet e AL-së kjo gjykatë i ka vlersu dhe vërtetu si të drejta dhe të bazuara në ligjë.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **Shpenzimet gjyqësore**

Vendimin për lirim për taksën gjyqësore u muar në pajtim me nenin Neni 8 pika 8.1 dhe 8.3.1 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, bazu në deshmin e paraqitur-Kartonin e ndihmës Sociale të Komunës së Kaçanikut sipas numrit të regjistrit 07-02796 të datës 09.01.2014, të lëshuar në emër të tij.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Dr.sc. Murat Hulaj, Gjyqtar

---